




Islamic Relief Kosova



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Direkcija za Poljoprivredu Šumarstvo i Ruralni Razvoj

Department of Agriculture Forestry and Rural Development

DATE\A:	11.08.2026
PËR/ZA/TO:	Fermerët e komunës së Skenderajt
PËRMES/PREKO/THROUGHT:	Kryetarin e Komunës, - z. Sami Lushtaku
NGA/OD/FROM:	Sabit Ferizi Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Thirrje për aplikim për mekanizëm bujqësor dhe serra 50m ²

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Skenderajt, në bashkëpunim me **Organizatën "Islamic Relief Kosova"**, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr. prot. 02-400/01-0025429/26, të datës **07.07.2026**, shpall Thirrje Publike për mbështetjen e fermerëve të Komunës së Skenderajt përmes implementimit të projekteve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Projektet që do të mbështeten

- Makinë mbjellëse për misër me **4 rende**;
- Makinë mbjellëse për grurë me **16 rende**
- Frezë **1.6 m**;
- Frezë **1.8 m**;
- Plug dy plorësh ;
- Makinë mbledhëse e barit me **traka dhe kardan**;
- Serrë **50 m²**.

Kriteret për përfitimin e mekanizmit bujqësor

Aplikuesi duhet të plotësojë këto kriterë

1. Të jetë banor i Komunës së Skenderajt .
Të ketë së paku **2 hektarë** tokë të punueshme dhe ta dëshmojë këtë përmes aplikimit për Pagesat Direkte 2026 për sipërfaqet e mbjella me grurë ose misër. Ky kriter vlen për përfituesit e makinës mbjellëse për grurë, makinës mbjellëse për misër, frezës për traktor, pllugit dhe mbledhëses së barit me traka dhe kardan.

2. Të jetë i regjistruar si fermer me Numër Identifikues të Fermës (NIF) para shpalljes së kësaj thirrjeje.

3. Të posedojë traktor.
4. Përparësi në përzgjedhje do t'u jepet fermerëve që nuk kanë përfituar më parë mbështetje nga Komuna e Skenderajt ose nga organizata të tjera donatore, me kusht që të plotësojnë kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj thirrjeje publike.
5. Përparësi kanë familjet me fëmijë jetim, të cilat plotësojnë edhe kriteret e përgjithshme.
6. Përfituesit duhet të sigurojnë **30% participim** në vlerën e projektit.

Kriteret për përfitimin e serrave

1. Të jetë banor i Komunës së Skenderajt.
2. Të jetë i regjistruar si fermer me Numër Identifikues të Fermës (NIF) para shpalljes së kësaj thirrjeje.
3. Të ketë hapësirë dhe kushte të përshtatshme për realizimin e projektit (serra duhet të vendoset jo më larg se **100 metra** nga shtëpia).
4. Aplikuesit për serra duhet ti ketë se paku 0.05 ha toke të punuar.
5. Të ketë përvojë në kultivimin e perimeve dhe mundësi për ujitje.
6. Përparësi në përzgjedhje do t'u jepet fermerëve që nuk kanë përfituar më parë mbështetje nga Komuna e Skenderajt ose nga organizata të tjera donatore, me kusht që të plotësojnë kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj thirrjeje publike.
7. Përparësi kanë familjet me fëmijë jetim, të cilat plotësojnë edhe kriteret e përgjithshme.
8. Përfituesit duhet të sigurojnë **30% participim** në vlerën e projektit.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

Aplikuesit duhet të dorëzojnë:

- Formularin e plotësuar të aplikimit;
- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikat e regjistrimit të fermerit (NIF)
- Certifikatën e Bashkësisë Familjare;
- Fletën poseduese të tokës;
- Dokumente dëshmuuese për familjet me fëmijë jetim;
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë.

Afati i aplikimit

Afati për aplikim fillon më **11.08.2026** dhe përfundon me **26.08.2026**, në ora **16:00**.

Formularët e aplikimit merren dhe dokumentacioni i plotësuar dorëzohet në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) në Komunën e Skenderajt.

Dispozita të tjera

- Çdo aplikues ka të drejtë të aplikojë vetëm për një nga pajisjet e lartpërmendura.
- Aplikuesit të cilët nuk i plotësojnë dokumentet dhe/ose kriteret e përcaktuara në këtë thirrje nuk do të merren në shqyrtim